



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-14702/20 2020

Klinë, 06. 05. 2020 30.06.2020

PROCESVERBAL

I Seancës së jashtëzakonshme, të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur më 06. 05. 2020, përmes postes elektronike.

Me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Klinës të dt.29.04.2020, për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme, Kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi, njoftoi se me dt.06.05.2020 do të mbahet Seanca e jashtëzakonshme e KK Klinë në formë elektronike gjerë në orën 16:00.

Me datën 06.05.2020 të gjithë anëtarët e Kuvendit, përveç znj. Shqipnora Dauti e cila një ditë më parë kishte dhënë dorëheqje nga mandati i sajë, anëtar i Kuvendit dhe se vendimi për zëvendësimin e sajë nuk kishte ardhur akoma në zyrën për punë e Kuvendit, si dhe z. Baki Gashi i cili nuk është deklaruar fare as për, kundër ose abstenim, dërguan porositë e tyre përmes postes elektronike në adresën zyrtare të shërbimit të kuvendit.

Pika e vetme e rendit të Ditës ka qenë: Propozim-vendimin për ndarje dhe transfer të mjeteve në shumën prej 90,000.00€ me qëllim të ndihmës ekonomike të familjeve me nevojë si dhe nevojave tjera për menaxhimin e vazhdueshëm të situatës për parandalimin e virusit Covid-19.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e FEZH, shuma e përgjithshme prej 90,000.00€, do të ndahet nga këto programe komunale:

1. Nga Planifikimi Urban dhe Mjedisi nga Shpenzimet kapitale 30,000.00€-nga projekti Bashkëfinancim me donator.
2. Nga programi Buxhetimi - Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në vlerë prej 18,000.00€.
3. Nga Programi Shërbimet Publike dhe Mbrojtja Civile në vlerë prej 22,000.00€.
4. Nga Programi I Arsimit-Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 20,000.00€.

Të gjitha këto transferohen në kodin e krijuar nga Qeveria e RK për shpenzimet rreth menaxhimit të pandemisë Covid-19.

Sipas deklarimeve të Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Klinës, përmes postës elektronike në adresë të Shërbimit për Punë të Kuvendit, shefit të kësaj zyre, grishe.gashi@rks-gov.net. Zyra për punë e Kuvendit- shefi i zyrës, proces shkruesi dhe kryesuesi i Kuvendit kanë konstatuar se me 25 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, është MIRATUAR propozim –Vendimi në fjalë.

Proces shkruar:

Skënder Behramaj



Kryeshtetari i Kuvendit

Fatmir Gashi